



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 95

Prishtinë, më 16.12.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Mimoza Sadiku – Lajminet, Bleta Gashi – Rrokum TV, Naim Krasniqi – Radio -Dukagjini, Petrit Hysaj dhe Floriana Shala – OSBE, Artan Canhasi – EULEX dhe Fidan Rama – Tribuna.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.10.2013;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i ekspertizës për Projektligjin për aktet normative të ekspertit, z. Idriz Tahiri.

Behar Selimi- Propozoi që si pikë e rendit të ditës të futet edhe shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Armend Zemaj- Tha se Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin është një ndër ligjet kryesore dhe ne duhet të njoftohemi paraprakisht me amendamentet e propozuara dhe jo të futet në rend dite si pikë shtesë. Ai ishte i mendimit se për shqyrtimin e këtij projektligji Komisioni mund të caktojë mbledhje të veçantë, qoftë edhe nesër mund të takohemi dhe ta shqyrtojmë.

Albulena Haxhiu- Ishte kundër që të futet si pikë e rendit të ditës për deri sa nuk kemi pasur material. Po ashtu dihet edhe fakti se po pretendohet që përmes ligjit të Buxhetit të bëhet shitja e 75% të aksioneve të PTK-së. Kjo është jashtë çdo praktike parlamentare dhe si e tillë për ne është e pa pranueshme.

Arben Gashi- Kryetari i Komisionit theksoi se amendamenti 8, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk ka bazë kushtetuese. Amendamenti në fjalë kishte të bënte me shitjen e 75% të aksioneve të PTK-së.

Për propozimin e deputetit Behar Selimi Komisioni ishte i ndarë, për futjen në rend dite ishin: Behar Selimi, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Sreten Ivanoviq dhe Mufera Shinik, kurse kundër votuan: Arben Gashi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Ardian Gjini.

Kryetari Konstatoi se rendi ditës miratohet me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.10.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtura më 21.10.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryetari paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari Konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligjin nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit

Armend Zemaj- Në cilësi të kryesuesit të grupit punues tha se jemi pajtuar që si grup punues të procedojmë për shqyrtim të mëtejshëm pasi e kemi përfunduar punën dhe le të vendos Kuvendi për miratim apo mosmiratim të këtij Projektligji.

Gëzim Kelmendi - Shprehu qëndrimin e tij kundër miratimit të këtij projektligji, për faktin se me dispozitat e këtij Projektligji bëhet përfshirja e pensionit të deputetit, e për deri sa ne ende nuk e kemi të rregulluar si duhet statusin e pensionisteve të Kosovës, si dhe duke pasur parasysh gjendjen ekonomike në vend, do të ishte jo e drejtë të kërkojmë pensione të tilla.

Albulena Haxhiu - Në fjalën e saj tha se edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për këtë Projektligj me të cilin ka shfuqizuar dispozitat që kanë të bëjnë me pensionin suplementar ka qenë i drejtë, sepse i jep fund shpërdorimit të fondeve publike, po ashtu sado pak e ul pabarazinë në mes të grupeve shoqërore. Në kohën kur pensionistet e Kosovës kërkojnë pensione me dinjitet, ne po kërkojmë pensione për vete, e që është shumë e pa drejtë.

Po ashtu duke pasur parasysh gjendjen socio-ekonomike në vend, ku 45% e qytetarëve jetojnë në varfëri ekstreme dhe 45 % të pa punë dhe ku paga mesatare nuk mbulon as shpenzimet minimale për jetë të kërkojmë që pensione që kalon shtatëfishin apo edhe më shumë të pagës mesatare në vend. Ne edhe ashtu kemi mjaft privilegje dhe pagë të mirë, andaj jemi kundër këtij Projektligji. Ajo paraqiti edhe shqetësimet lidhur me mos përfshirjen e legjislativave të kaluara, që sipas saj, nëse është dashtë të ketë privilegje, edhe ajo kategori meriton privilegje me ligj.

Armend Zemaj - Në fjalën e tij të serishme sqaroi se është punuar shumë deri në harmonizimin e qëndrimeve dhe sugjeroi parafolësit që diskutimet politike të lënë për seancë plenare. Sa për dijeni ky ligj bëhet për ish- deputetët dhe jo për deputetët dhe i parasheh kushtet se si realizohet kjo e drejtë. Andaj unë i respektoj mendimet e kolegeve që kanë, qoftë individuale apo ne emër

të grupit parlamentar, por është koha që ta procedojmë tutje dhe Kuvendi le të vendos nëse do ta aprovojë apo jo. Kurse lidhur me implikimet buxhetore tha se duhet t'i dërgohet Komisionit për buxhet dhe financa.

Ardian Gjini- Tha se dilema të tilla se a duhet të këtë ligj të tillë që rregullojnë të drejtat dhe privilegjet e deputetëve ka pasur edhe në shumë shtete që kanë kaluar në këto sfida, e që janë normale për shtetet e reja. Është një dilemë që ka ekzistuar edhe në vitet e 20-ta në shtetet si Franca, Anglia dhe Amerika dhe ka qenë ideologjike fakti se a pritet prej njerëzve që nuk e kanë të siguar ekzistencën e vetë, ata të jenë në gjendje të mendojnë për të ardhmen e të tjerëve. Ai tha se kjo çështje nuk ka të bëjë me individin, deputetin, por ka të bëjë me faktin se është shumë normale që njerëzit që kanë frikë prej të ardhmes së tyre, sepse nuk kanë asgjë të rregulluar me ligj, të mendojnë për të tjerët. Ai tha se deputetet që marrin vendime për popullin, në momentin që nuk do të jenë të zgjedhur do të kenë probleme me ekzistencë, prandaj mos pritni prej tyre që gjatë kohës sa janë në mandat ata do të mendojnë më shumë për tjerët sesa për vete.

Arsim Bajrami- Shprehu mendimin e tij individual, jo të subjektit politik, se është kundër përfshirjes së pensionit suplementar për deputetët duke pasur parasysh gjendje ekonomike në vend. Ky projektligj duhet shikuar në dy aspekte, e para, duhet lirohet nga aspekti socialist se nuk ka trashëgimi të privilegjeve në vendet me demokraci të zhvilluar dhe e dyta nevoja për një ligj të tillë. Ai tha se tendenca e Komisionit të Venecias është të bëjë shkurtime drastike të privilegjeve të deputetëve, apo imunitetit, gjatë mandatit dhe pas mandatit. Shtete kanë qasje të ndryshme, sidomos shtetet e ish- regjimeve socialiste që të nxjerrin ligje të tilla, mirëpo tendencat e reja të parlamentarizmit modern janë që deputeti të mos marrë të drejta me vete pas përfundimit të mandatit.

Pas diskutimeve, Komisioni me 9 vota “për “ 2 vota “kundër” vendosi që të kërkojë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që të bëjë vlerësimin e kostos financiare (buxhetore) të Projektligjit, para procedimit për Kuvend.

5. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i ekspertizës për Projektligjin për aktet normative të ekspertit, z. Idriz Tahiri

Kryetari i njoftoi me përmbajtjen e ekspertizës për Projektligjin për aktet normative të ekspertit, z. Idriz Tahiri, e cila ju është shpërndarë së bashku me materialin për këtë mbledhje dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje para se të procedohet tutje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari Konstatoi se Konfirmohet përfundimi ekspertizës sipas kushteve të përcaktuara në termat e referencës.

b. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2104.

Behar Selimi- Në fjalën e tij tha se është e rëndësishme që të shqyrtohet raporti me amendamente i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, ndërsa sa i përket amendamentit 8, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nëse ndokush vlerëson se është kundër kushtetuese, për vlerësim të tillë ekziston Gjykata Kushtetuese dhe mund ta dërgojë për vlerësim.

Kryetari shprehu shqetësimin se është jo e drejtë që një Projektligj kaq të rëndësishëm ta trajtojmë me kaq urgjencë. Veçmas shprehu shqetësimin lidhur amendamentin 8, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që sipas tij nuk ka bazë kushtetuese.

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me Projektligjin, veçmas shprehen shqetësimet lidhur me procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit dhe për amendamentin 8. Lidhur me procedimin e raportit me amendamente në Kuvend, Komisioni ishte i ndarë, ku për procedimin e raportit në Kuvend votuan: Behar Selimi, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Sreten Ivanoviq dhe Mufera Shinik, kurse kundër votuan: Arben Gashi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Ardian Gjini.

Kryetari Konstatoi se Komisioni për Legjislacion se me 6 vota “për” dhe 5 “kundër”, nxori këtë:

REKOMANDIM

- 1. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.*
- 2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:55

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit
Arben Gashi
